

CONTINUO LINK ART

ASTAR DEKORATIV BIKOMPONENT ME BAZË REZINË EPOKSIDE NË DISPERSION UJOR
Seri 124/125

PËRSHKRIMI

CONTINUO LINK ART është astar bazë transparent I aftë të ruajë efektin natyral të veshjes dekorative CONTINUO DECO, duke garantuar në të njëjtën kohë konsolidimin sipërfaqësor.

CONTINUO LINK ART ruan të paprekura sfumaturat dhe tonet e ngjyrave të kërkuara nga klienti duke garantuar një efekt të qartë dhe të besueshëm të efektit dekorativ të përzgjedhur. CONTINUO LINK ART është astar bikomponent I përbërë nga rezina epokside në dispersion ujor të gjeneratës së re dhe një katalizator që garanton tharje të shpejtë dhe emisione shumë të ulëta të komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC).

Sistemi CONTINUO është I klasifikuar A+ sipas dekretit ministerial francez për cilësinë e ajrit në ambiente të brendshme.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

-Sipërfaqe të dekoruara me CONTINUO DECO.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Natyra e lidhësit: Epoksid dhe katalizator specifik

-Solventi: ujë

-Raporti I përzierjes në peshë: 1 pjesë komp. A + 0.7 pjesë komp. B.

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1:

-Komponenti A=1.06±0.05 kg/l

-Komponenti B=1.03±0.05 kg/l

-Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1.05±0.02 kg/l

-Jetëgjatësia e përzierjes (A+B): rreth 60 minuta në 20 °C.

Përzierja (A+B) edhe nëse është ende fluide (e lëngshme/e rrjedhshme) nuk duhet të përdoret përtej kësaj kohe.

-Aspekt me shkëlqim

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 1 ore.

Në sipërfaqe mund të ecet me këpucë të posaçme pas rreth 3 orësh.

Faza tjetër e lyerjes me finiturën TOP ose TOP ART mund të bëhet pas të paktën 4 orësh nga punimi.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sistemi dekorativ CONTINUO: shihni udhëzimet dhe në skedën teknike përkatëse.

Dysheme betoni CLS:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë ose të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes, çarjet dhe plasaritjet mund të trajtohen me produkte specifike.

-Kontrolloni gjendjen e pjesëve të trajtuara më parë.

Pjesët që nuk janë aderuar mirë duhet të hiqen.

-Depozitimet e pluhurit, smogut, vajrave, yndyrnave dhe të tjerë ndotës duhet të hiqen me zmerilim të lehtë ose me detergjentë specifikë.

-Në sipërfaqe të tharë vazhdoni me aplikimin e CONTINUO LINK sipas udhëzimeve të përshkruara.

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:

Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +45 °C

Lagështira relative e ambientit: <85%

Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +45 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Mjetet: pinel, rrul me qime mesatare, spruco të përshtatshëm ose Airless.

Produkti I përfutur nga përzierja e një pakete të plotë A dhe një paketë të plotë B, normalisht do të hullohet duke shtuar afërsisht 2,1 litra ujë (hollimi 250%).

-Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.

-Përzierja (katalizoni) dhe përdorni një paketim për një herë (komp. A + komp. B).

-Nr. i shtresave: 1 shtresë.

-Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin në vazhdimësi, duke shmangur prekjen me rrul ose pinel të sipërfaqes së aplikuar ndërkohë që filmi thahet.

-Pastrimi I mjeteve duhet të bëhet menjëherë me ujë pas përdorimit.

-Shkalla e mbulimit: influencohet shumë nga natyra e produktit që do mbulohet. Për sipërfaqe lisho mesatarisht absorbuere konsumohet 12-15 m²/l për shtresë (produkt I holluar), rreth 35-40 m² për paketim me 1 shtresë.

NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm neutro, nuk ngjyrosset.

CONTINUO LINK ART

ASTAR DEKORATIV BIKOMPONENT ME BAZË REZINË EPOKSID NË DISPERSION UJOR
Seri 124/125

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30°C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5°C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/j: bojë bikomponente me performancë të lartë (bazë uji): 140 g/l (2010)
Produkti përmban max: 140 g/l VOC
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient. I lini të thahen dhe l trajtoni ato si mbetje të vecanta. Mos l hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Astar epoksid dekorativ bikomponent l hollueshëm me ujë, transparent, l lehtë në aplikim, me fuqi të lartë penetruese.
Aplikimi, në 1 shtresë me një rreze prej 12-15 m²/l, të produktit të holluar, për shtresë.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti l produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.